

VENDIM
Nr. 29, datë 17.1.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHETËTËRORE TË
MINISTRIT TË SHETËTIT PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE
ANTI-KORRUPSIONIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin është përgjegjës për administratën publike dhe për luftën kundër korrupsionit.

3. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin ushtron veprimtarinë në këto fusha përgjegjësie shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:

a) drejtimin dhe bashkërendimin e punës për propozimin e akteve dhe politikave, për:

- menaxhimin dhe energjizimin e burimeve njerëzore të administratës publike;

- ndërtimin e institucioneve të administratës shtetërore;

- trajnimin e të punësuarve të administratës publike.

b) drejtimin dhe bashkërendimin e punës për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

4. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin ka rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, si dhe ushtron çdo përgjegjësi tjetër shtetërore që i ngarkohet me ligj, me akte të Këshillit të Ministrave dhe nga Kryeministri.

5. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin është përgjegjës për përmbushjen e parimeve të qeverisjes së mirë dhe partneritetit për qeverisje të hapur.

6. Ngarkohet ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku